



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 22.04.2016

Ref.: 238/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 41-të, të mbajtur më 14 prill 2016, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet në nivel institucional Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019.
- II. Aprovohet kërkesa e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, datë 16.11.2015, nr. 497/15, për njohjen e akreditimit të programeve të studimit të cilat janë akredituara me vendim të KSHC-së nr. 540/14, datë 04.07.2014, për këto programe të studimit:
 - Arkitekturë e interiorit dhe dizajni i mobileve / BSc, (180 ECTS);
 - Menaxhment industrial / BSc, (180 ECTS);
 - Inxhinieri industriale dhe informatikë / BSc, (180 ECTS)

për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019.

Programi i studimit:

- Menaxhment i turizmit dhe hotelerisë / BSc, (180 ECTS)

njohja e akreditimit vlen për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2017

A r s y e t i m i

Duke u bazuar në kërkesën për akreditim institucional të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, datë 16.11.2015, nr.497/15, të gjeturat nga vizita e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit në përbërje prej, Laima Taparuskienė, Alexander Petutschnigg, Lina Nunes, të realizuar më 9 mars 2016 dhe rekomandimet përfundimtare

të dhëna nga ekipi i ekspertëve, nenit 15, pika 3 e Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011, dhe dispozitave tjera të cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë